

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

---

### Përlësia e patrazuar<sup>1</sup> / *el-Ikhbaat* /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

“Përgëzoji *mukhbitiin* (të përlurit para Zotit)” (el-Haxh, 34)

*Ikhbaat* është stacioni i parë i rehatisë dhe nënkupton strehimin nga kthimi mbrapsht dhe nga lëkundja.<sup>2</sup> Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është kur:

- Mbrojtja (hyjnore) përfshin dëshirat<sup>3</sup>
- Vullneti mbulon shkujdesjen<sup>4</sup>
- Ndjekja e zellshme (e të Dashurit / Zotit) shkatërron mbajtëset e rehatisë dhe të relaksimit<sup>5</sup>

Niveli i dytë është kur:

---

<sup>1</sup> Nëse *khushû* (përlësia solemne) është një kombinim i përlësisë me gjakftohtësinë, *Ikhbaat* (përlësia e patrazuar) është një kombinim i përlësisë me rehatinë. Ky lloj i përlësisë rezulton nga familjarizimi me Atë të cilit i dorëzohesh dhe nga mirëbesimi që Ai ka. Kjo e bën dorëzimin / përlësinë tënde të lehtë dhe kthimin mbrapsht të papërfytyrueshëm.

<sup>2</sup> Tash që ti jo vetëm që respekton Zotin, por dhe gjen prehje në praninë e Tij, do të jesh imun nga kthimi mbrapsht apo nga ngurrimi për t’iu përkushtuar cilësdo kërkesë të rrugëtimit.

<sup>3</sup> Kështu, asnjë dëshirë jotja s’do të jetë më e madhe sesa mbrojtja hyjnore (*‘ismeh*) që të ofrohet, gardhi i së cilës do të jetë tepër i lartë për kuajt e egër të dëshirave tua.

<sup>4</sup> Para kësaj shkalle (stacioni), vullneti dhe shkujdesja kanë qenë në garë me njëra-tjetrën dhe nganjëherë njëra ka tejkaluar tjetrën. Tash, vullnetin yt është gjithmonë përpara shkujdesjes, gjë që të ruan nga pasojat (simptomat) e saj.

<sup>5</sup> Sado që dynjaja të bëhet komode, ajo nuk do të të shpërqendrojë më nga të kërkuarit tënd të Allahut.

- Asnjë shkak nuk zbraps vullnetin tënd
- Asnjë pengesë nuk i shkakton zemrës sate ankthin e vetmisë<sup>6</sup>
- Asnjë sprovë nuk ndërpret rrugëtimin tënd

Niveli i tretë është kur:

- Lavdërimi dhe kritika (nga njerëzit) bëhen të barabarta për ty<sup>7</sup>
- Vetëqortimi bëhet i vazhdueshëm<sup>8</sup>
- Ti nuk sheh nivelet e ulëta të njerëzve në krahasim me ty<sup>9</sup>

---

<sup>6</sup> Madje edhe mungesa e shoqëruesve dhe e mbështetësve nuk e bën zemrën tënde të ndihet e vetmuar dhe e shqetësuar.

<sup>7</sup> Mund të thuhet se kjo nuk qe e vërtetë as në rastin e pejgamberëve e të Dërguarve, meqë edhe Ibrahim i kërkoi Allahut "... prestigj tek gjeneratat e mëvonshme" (esh-Shu'araa, 84). Kuptimi i saktë i kësaj është se as lavdërimi e as kritika nuk do të të shmangin nga ndjekja e së vërtetës dhe të synuarit tënd të Atij.

<sup>8</sup> Por pa e tepruar në këtë. Aliu ﷺ tha: "Zemrat verbohen, kur mposhten."

<sup>9</sup> Atëherë, ti nuk sheh veten më të mirë se ndokush. Edhe kur mendimi i këtitillë të vjen ndër mend dhe ti nis të konsiderosh se ke ndonjë meritë, e largon duke kujtuar faktin se krejt çfarë ke (apo çfarë ke arritur) është një favor nga Allahu që Ai mund të ta marrë kur të dojë; po ashtu duhet të kujtosh se "Vepra gjykohen sipas përfundimeve të tyre."